

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	15480/25
Nr. i fq. / Br. st	- 4 -
Data: / Datum	11.04.2025
VUSHTRRI - VUČITRN	



KOMUNA VUSHTRRISË

02 Nr. 485/25  
Dati, 11.04.2025

**IBËR-LEPENC**<sup>SH.A. D.O.</sup>  
02-1122 D. 11-04-2025  
PRISHTINË-PRIŠTINA



N.H. "Ibër-Lepenc" sh.a. -Prishtinë

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

KOMUNËS SË VUSHTRRISË

DHE

"IBËR - LEPENC" Sh.A

PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT  
PËR UJITJEN E KULTURAVE BUJQËSORE NË KOMUNËN E VUSHTRRISË

1. "IBËR LEPENC" Sh.A- Prishtinë, përfaqësuar nga z.Faruk Mujka, Kryeshef Ekzekutiv
2. KOMUNA VUSHTRRI, përfaqësuar nga z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës (në tekstin e mëtejmë Komuna)

I  
QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është përcaktimi i obligimeve të përbashkëta institucionale duke përfshirë mbështetjen financiare nga Komuna e Vushtrrisë në funksion të ujitjes së kulturave bujqësore në komunën e Vushtrrisë.

Realizimi i Projektit për ujite në Komunën e Vushtrrisë, duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve të Komunës, është në përputhje me politikat e Komunës së Vushtrrisë, si dhe ka për qellim përkrahjen e bujqve në Komunën e Vushtrrisë, duke ndikuar në këtë formë ne rritjen e rendimenteve bujqësore.

## II OBLIGIMET E PËRBASHKËTA

1. Palët, në funksion të realizimi të qëllimit të përcaktuar në nenin një (1) të këtij Memorandumi marrin përsipër këto obligime të përbashkëta:

- 1.1. Mbështetje financiare për fermerët me 50% të vlerës se faturës nga vlera e përgjithshme e 110 euro për hektar, për ujitjen e kulturave bujqësore nga Komuna e Vushtrrisë, të cilat mjete do të paguhen nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, kategoria e subvencioneve, në llogarinë e N.H."Ibër-Lepenc"Sh.A. Prishtinë, (140100000922261 Banka Ekonomike), jo më vonë se 15.10.2025, përkatësisht brenda 15 ditëve pas dërgimit te dokumentacionit përkatës në Komune, siç theksohet në nenin III paragrafi 1.3.
- 1.2. Sigurojnë realizimin e suksesshëm të projektit dhe përbushjen e qëllimit të këtij memorandumi;
- 1.3. Udhëheqin në bashkëpunim procesin e mbështetjes financiare në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

## III OBLIGIMET E PALËVE

### 1. Komuna e Vushtrrisë

- 1.1. Mbështetë realizimin e projektit për financimin e fermerëve në vlerë të 50% të faturës për ujitjen e kulturave bujqësore.
- 1.2. Komuna e Vushtrrisë merr përsipër pagesën e 50 % të faturave për ujite, sipas kërkesave të fermerëve.
- 1.3. Me rastin e ekzekutimit të mjeteve financiare nga Komuna e Vushtrrisë, N.H."Iber Lepenc"Sh.A, merr përsipër të përcjellë tek komuna, të dhënat për realizimin e projektit siç janë: kontratat për ujite, faturimin dhe listat e fermerëve me shënimet e tyre përkatëse.

### 2. N.H."Iber Lepenc"Sh.A

- 1.1 Në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë, kujdesen për realizimin e suksesshëm të projektit përmes ofrimit të çfarëdo asistence profesionale, administrative dhe teknike që

mund të jetë e nevojshme dhe që është në përgjegjësinë dhe mandatin e saj. NH. "Iber-Lepenc" obligohet të filloj procesin e ujitjes sipas kërkesave të fermerëve.

#### IV ZBATIMI

1.1 Komuna e Vushtrisë dhe N.H."Ibër - Lepenc"Sh.A, përcjellin zbatimin e memorandumit përmes komisionit të përbashkët i cili emrohet me vendim mënjerëherë pas nenshkrimit të këtij memorandumi.

1.2 Komisioni është përgjegjës për veprime që duhet të ndërmerren në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara në ketë Memorandum.

#### V PLOTËSIM NDRYSHIMI APO SHKËPUTJA EVENTUALE E MEMORANDUMIT

1. Ndërprerja e Memorandumit të Bashkëpunimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve, por që nga ky memorandum nuk mund të lirohen palët, pa i përmbushur obligimet.

2. Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të fuqisë mbinatyrore -palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me njëra - tjetrën për veprimet që duhet të ndërmerren.

3. Afati i realizimit të projektit sipas këtij Memorandumi duhet të arrihet gjatë sezonit të ujitjes në vitin 2024, jo më larg se data 31.10.2025.

4. Ky Memorandum i Bashkëpunimit mund të ndryshojë apo plotësohet sipas një aneks marrëveshje me shkrim midis palëve.

5. Ky Memorandum ka titull ekzekutiv.

#### VI ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Palët do të përpiken qe mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjdh rastet e tilla.

#### VII NËNSHKRIMI I MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në katër (4) kopje identike origjinale, nga dy (2) për palët nënshkruese.

**VIII**  
**HYRJA NË FUQI**

Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.


Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës së Vuçitrnës  
Lepenc"Sh.A

Faruk Mujka



  
Feshef i N.H. "Ibër -

Nënshkruar më 11 / 04 / 2025